



Oda e Administratorëve të Falimentimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Oda e Administratorëve të Falimentimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në bashkëpunim me Projektin e Bankës Botërore për zgjidhjen e borxhit dhe daljen e biznesit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në përputhje me nenin 23 paragrafi 2 të Ligjit për falimentim, publikon:

THIRRJE PUBLIKE

për regjistrimin e kandidatëve për trajnim fillestar për kryerjen e punëve të administratorit të autorizuar të falimentimit

Njoftohen personat e interesuar se organizohet trajnim fillestar në kohëzgjatje prej së paku 30 orë për kandidatët për kryerjen e punëve të administratorit të autorizuar të falimentimit.

Të drejtë për të ndjekur trajnimin fillestar kanë vetëm personat fizikë që plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- të ketë vendbanim në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- të ketë arsim të lartë në një fushë përkatëse (diplomë për arsim të lartë katërvjeçar të përfunduar ose diplomë me 300 kredi, sipas Sistemit Evropian për transfer të kredive (ECTS));
- të ketë të paktën tre vjet përvojë pune pas diplomimit në fushën e drejtësisë, ekonomisë ose administrimit të biznesit;
- ose pesë vjet përvojë pune në fushën e veprimtarive tregtare pas diplomimit për një arsim tjetër të lartë;
- me vendim të formës së prerë se nuk është vendosur ndalim për kryerjen e një profesioni, veprimtarie ose detyre për aq kohë sa zgjasin pasojat e ndalimit.
- me vendim të plotfuqishëm të mos i jetë shqiptuar ndalim të ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës për aq kohë sa të zgjasin pasojat e ndalimit.

Personave që do të ndjekin trajnimin fillestar do t'u lëshohet certifikata e përfundimit të trajnimit fillestar dhe do të kenë të drejtë të japin provimin profesional për marrjen e certifikatës për administrator të autorizuar të falimentimit, që e zbaton Komisioni i caktuar nga Ministri i Ekonomisë.

Kandidatët të cilët janë të interesuar të ndjekin trajnimin fillestar për kryerjen e punëve të administratorit të falimentimit duhet të paraqesin aplikim pranë Odës së Administratorëve të Falimentimit me një biografi të shkurtër dhe fotokopje të dokumenteve që vërtetojnë kushtet e thirrjes publike.

Për pjesën tjetër të aktiviteteve për trajnimin fillestar, kandidatët do të njoftohen shtesë në adresën e specifikuar në aplikim.

Aplikimet me dëshmitë e nevojshme të dorëzohen në adresën: Oda e Administratorëve të Falimentimit, rr. Vasil Stefanovski nr. 26/16 Shkup, ose në e-mail adresën: komorasu@komorasu.org.mk



Oda e Administratorëve të Falimentimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Afati i fundit i aplikimit është më së voni deri më 18.01.2024.

Kontakt informacione çdo ditë pune nga ora 10:00 deri në 14:00 në telefonat: 02/3223-857; dhe 070/210 308- Zhaklina Sasanska.

14.12.2023
S h k u p

Kryetar
Biljana Stefanovska